

PYETJE TË SHPESHTA – GRANTI I BAZUAR NË PERFORMANCË 2025

? Çfarë është Granti i Bazuar në Performancë (GBP)?

Granti i Bazuar në Performancë është një formë financimi shtesë për bashkitë në Shqipëri, e cila jepet në mënyrë konkurruese në varësi të përmbushjes së një grupi treguesish të matshëm të performancës. Qëllimi i këtij granti është të nxisë përmirësimin e qeverisjes vendore, forcimin e kapaciteteve administrative dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

? Kush e financon grantin?

Granti është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe dy donatorëve ndërkombëtarë: Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA). Për vitin 2025, fondi total i vënë në dispozicion është 460 milion lekë.

? Kush ka të drejtë të aplikojë?

Të gjitha bashkitë e Republikës së Shqipërisë kanë të drejtë të aplikojnë për grantin, pavarësisht madhësisë apo vendndodhjes, për sa kohë që përmbushin kriteret dhe dorëzojnë dokumentacionin përkatës brenda afateve të përcaktuara.

? Cilat janë treguesit që vlerësohen?

Në total janë 10 tregues performancë, të cilët përfshijnë përgatitjen dhe miratimin e planeve vendore (si p.sh. Plani i Mbetjeve, Plani Social, etj.), si dhe tregues financiarë (si shlyerja e detyrimeve të prapambetura, realizimi i buxhetit, etj.). Secili tregues ka një peshë të caktuar në vlerësim.

? Si bëhet vlerësimi i aplikimeve?

Procesi i vlerësimit kryhet nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve (KVA), i cili përfshin përfaqësues nga ministritë përkatëse, Shoqata e Bashkive dhe AMVV. Vlerësimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe udhëzimet përkatëse.

? Çfarë dokumente duhen dorëzuar nga bashkitë?

Bashkitë duhet të dorëzojnë dokumentacionin që provon përmbushjen e secilit tregues, përfshirë planet përkatëse, vendimet e Këshillit Bashkiak dhe të Qarkut, aktet e konfirmimit nga Prefekti, procesverbalet dhe lidhjet e publikimit në faqet zyrtare.

? A mund të përdoret granti për pagat e punonjësve?

Jo. Granti nuk mund të përdoret për të financuar paga apo shpërblime.

? A është i detyrueshëm miratimi i planeve nga këshilli bashkiak?

Po. Të gjitha planet që përfshihen në aplikim duhet të jenë të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe të konfirmuara nga Prefekti, në përputhje me procedurat ligjore përkatëse. Pa këto dokumente, plani nuk konsiderohet i vlefshëm për qëllimet e vlerësimit.

? Çfarë ndodh nëse një bashki nuk ka detyrime të prapambetura?

Nëse një bashki nuk ka detyrime të prapambetura të regjistruara në fund të vitit 2024, ajo do të konsiderohet automatikisht si përmbushëse e këtij treguesi dhe do të marrë pikët maksimale për të.

? Çfarë ndodh me fondet e pashpenzuara gjatë vitit?

Në rast se bashkia nuk arrin të shpenzojë të gjitha fondet e përfituara brenda vitit kalendarik, ajo mund t'i përdorë ato në vitin pasardhës, për qëllime të përcaktuara me një vendim të ri të Këshillit Bashkiak, në përputhje me objektivat fillestare të financimit.

? Në treguesin e vendosur për realizimin e buxhetit do të përfshihet çdo burim financimi apo vetëm ato me kapitujt 01 dhe 05?

Sipas udhëzimit nr. 1, datë 11.7.2025 për grantin e bazuar në performancë, në indikatorin TP9 ("Realizimi i Planit të Buxhetit të Bashkisë"), për t'u konsideruar si i përmbushur, **bashkia duhet të ketë realizim faktik të buxhetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 në masën jo më pak se 35% të planit vjetor për 2025.** Raporti i të dhënave për planin dhe faktin e realizimit të buxhetit të bashkive, për periudhën referuese, gjenerohet nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë. **Për këtë arsye të dhënat e referuara do të jenë ato që gjeneron ky sistem.**

Në këtë sistem, për qëllime të matjes së performancës, siç ndodh në praktikën e mëparshme dhe në përputhje me udhëzimet teknike të Ministrisë së Financave, zakonisht përfshihen vetëm kapitujt 01 dhe 05, pra zërat buxhetorë që lidhen me shpenzimet korrente dhe investimet kapitale.

Përmbledhje:

- **Jo, nuk përfshihen të gjitha burimet e financimit në përllogaritje të treguesit të realizimit të buxhetit.**
- **Po, përllogaritja bazohet vetëm në kapitujt buxhetorë 01 (shpenzime korrente) dhe 05 (shpenzime kapitale), sipas praktikës standarde të raportimit në GFIS dhe për qëllime të grantit të performancës.**

? A duhet të jetë Aleancat e Grave dhe Vajzave në Politikë pjesë e grupit të punës për hartimin e Planit të Barazisë Gjimore?

Grupi punës për hartimin e një plani vendor ngrihet në parim me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Pjesë e këtij grupi mund të jenë struktura të ndryshme brenda Bashkisë, në varësi të kontributit që mund të ofrojë çdo person apo strukturë e përfshirë. Po ashtu, gjatë punës

për planin mund të zhvillohen konsultime me këshillin e bashkisë, specifikisht me komisionet përkatëse apo trupat konsultuese të ndërtuara nga KB, siç mund të jetë rasti i Aleancave të Grave dhe Vajzave në Politikë.

? Në rastet kur ka detyrime që lidhen me vendime të gjykatave, a konsiderohen këto në matjen e shkallës së detyrimeve të pashlyera? Shembuj më poshtë nga Bashkia X.

- Vlera prej 2.346.886 detyrim ndaj FSHU (OSHEE) për të cilin jemi në proces gjyqësor sipas kërkesë padisë nr. NNN datë DD.MM.VVVV
- Detyrimi prej 302 088 lekë i kontabilizuar në favour të BBBB CCCC sipas Vendimit nr. NNNN datë DD.MM.VVVV të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është rrëzuar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Tiranë.
- Gjatë vitit 2025 është kontabilizuar detyrimi gjyqësor për subjektin SSSS në vlerën 163,299, vlerë e cila është likuiduar në datën 18.03.2025 pra brenda gjashtëmujorit të parë.

Në parim çdo detyrim i regjistruar i Bashkisë do të jetë pjesë e përlogaritjes për treguesin e vendosur për Grantin e bazuar në performancë.